



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01. nr. - 031-266410, më 27 -10- 2016

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L - 040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit të lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe "Trafikut Urban" SH.A. të dt. 01.01.2016, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me 24.10.2016, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi për subvencionimin e ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban" SH.A.
- II. Shuma e mjeteve financiare për subvencionimin e ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban" SH.A., nga pika I e këtij Vendimi, do të jetë 9,900 €.
- III. Shuma e cekur në pikën II të këtij Vendimi, i ndahet ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban" SH.A për shërbimet e kryera gjatë muajit Shtator 2016, në pajtim me Marrëveshjen e mirëkuptimit të dt. 01.01.2016.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave dhe Pronës e Komunës së Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I'u dërgohet:

- NPL "Trafiku Urban" SH.A.,
- Drejtorisë për Pronë dhe Financa, dhe
- Qendrës për shërbime me qytetar.

